



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.07.2018, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të datave 02.07.2018, 03.07.2018, 05.07.2018, 09.07.2018 dhe 10.07.2018.

2. Vazhdimi i shqyrtimit nen për nen dhe miratimit në tërësi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar”. *(Komision përgjegjës)*

3. Miratimi i projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorit të Përgjithshëm gjatë vitit 2017”. *(Komision përgjegjës)*

4. Miratimi i projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2017”. *(Komision përgjegjës)*

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Alket Hyseni, Edmond Leka, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Elena Xhina, Arben Pëllumbi dhe Tom Doshi.

Mungojnë: Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi Tyli, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Silva Caka.

Të ftuar:

Ardiana Jaku – Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Merita Xhafaj – Drejtoreshë e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të

Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Etleva Sheshi – Përgjegjëse e Sektorit të Politikave dhe Strategjive për Përfshirjen Sociale dhe Barazinë Gjinore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Ardian Shega – Drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme.

Meqenëse kuorumin e kemi për të vazhduar me katër çështjet që kemi në rendin e ditës, fillojmë me miratimin e procesverbaleve të mbledhjeve të komisionit të datave 02.07.2018, 03.07.2018, 05.07.2018, 09.07.2018 dhe 10.07.2018.

Ka vërejtje lidhur me procesverbalet? Nuk ka.

Miratohen procesverbalet e mbledhjeve të Komisionit të datave 02.07.2018, 03.07.2018, 05.07.2018, 09.07.2018 dhe 10.07.2018.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi vazhdimin e shqyrtimit nën për nen dhe miratimit në tërësi të projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar”. Komisioni ynë është komisioni përgjegjës. Relatore është kolegja Vasilika Hysi.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale zonjat Adriana Jaku, zëvendësministre, e cila nuk është paraqitur; Merita Xhafaj, drejtore e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si dhe zonja Etleva Sheshi, përgjegjëse e Sektorit të Politikave dhe Strategjive për Përfshirjen Sociale dhe Barazinë Gjinore, ndërsa nga Ministria e Drejtësisë kemi zotin Ardian Shega, drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit.

Mirë se keni ardhur në komision!

Në fakt, nga mbledhja e kaluar ne kemi lënë të hapura, në mos gaboj, katër nene të këtij projektligji, për të cilët besoj se relatorja dhe përfaqësuesit e ministrive respektive janë dakordësuar.

Ndaj, pa humbur kohë, vazhdojmë me nenin e parë që e kemi lënë të hapur.

Zonja Hysi, fjala është për ju.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Bëhet fjalë për nenin 2 të projektligjit, që ndryshon nenin 3 të ligjit aktual, që ka të bëjë me përkufizimet; nen që është dakordësuar. Ai lidhet me çështjen e urdhit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme, që është pika 12, ndërkohë çështja tjetër lidhet me atë çfarë ju me të drejtët e ngritët, por edhe ne e kishim shqetësim, atë që quhet marrëdhënie intime.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është rregulluar dhe është perkufizuar sipas projektit që keni përpara: “Marrëdhënia intime përfshin një intimitet fizik ose emocional”...

Ulsi Manja – Atëherë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Pjesa tjetër e perkufizimeve është diskutuar dhe kolegët nuk kanë pasur vërejtje.

Ulsi Manja – Dakord?

Hedhim në votim nenin 2, që ndryshon nenin 3. Kush është dakord me nenin 2, sipas riformulimit dhe dakordësimin të bërë ndërmjet relatores dhe përfaqësuesve të qeverisë?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 2.

Kalojmë te neni...

Vasilika Hysi – Te neni 10.

Ulsi Manja – ...që ndryshon?

Vasilika Hysi – Në fakt, neni 10 shton një nen të ri, nenin 13/1, që ka të bëjë me urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Meqenëse është një instrument i ri që i jep policisë tagrin ta mbrojë viktimën menjëherë sapo ajo referon një rast në polici, u pa e nevojshme që, ndryshe nga projektligji i sjellë nga qeveria, i cili referonte te neni 10 të njëjtat masa që mund të jepeshin me vendim gjykate, të jepeshin edhe nga punonjësit e policisë. Domethënë, nga grupi i punës, në konsultim me Ministrinë e Drejtësisë, me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me Ministrinë e Brendshme bashkë edhe me kolegen Bushka, unë dhe këshilltarja ligjore, u gjykua se duhej bërë një nen i veçantë për ta saktësuar, dhe këtu keni listën e masave paraprake që jepen në rastet e mbrojtjes së menjëhershme nga punonjësit e Policisë së Shtetit ose strukturat e ngritura pranë kësaj të fundit.

Po të shikoni janë një sërë masash, përmbajtjen e të cilave e keni përpara. Pra, urdhri mund të japë disa prej këtyre masave. Nuk e di nëse dëshironi ta lexojmë apo nëse keni ndonjë pyetje.

Ulsi Manja – Jo, nuk është e nevojshme, pasi kolegët e kanë mbi tryezë. Pra, është neni 10, që shton nenin 13/1, “Urdhri për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme”.

Kush është dakord me nenin 10 sipas 5 riformulimeve të bëra nga relatorja, të dakordësuara me qeverinë?

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 10.

Kalojmë te neni 11, që ndryshon nenin 14 të ligjit aktual.

Vasilika Hysi – Ky nen ka të bëjë me kërkesëpadinë. Në projektligjin e sjellë nga qeveria shtohen pikat 3, 4 dhe 5. Ne kemi bërë një riformulim. Nëse kolegët janë dakord me riformulimin...

Ulsi Manja – A ka gjetur zgjidhje të dokumentacioni shoqëruar që do të shoqërojë urdhrin/kërkesën për marrjen e urdhrit, që barra i kalon institucionit?

Vasilika Hysi – Nëse e shikoni, në radhë të parë këtu kanë gjetur rregullim 2 ligjet që ne sapo i kemi miratuar në Kuvendin e Shqipërisë. E drejta që ka kërkuar i një urdhri të menjëhershëm të mbrojtjes ose kërkuar i urdhrit të mbrojtjes për t'u përjashtuar nga pagimi i tarifave të shpenzimeve gjyqësore dhe detyrimi për të parapaguar tarifën për vënien në ekzekutim, të cilat kanë qenë një problem shumë i madh për viktimat e dhunës në familje.

Po ashtu, edhe përjashtimi nga pagimi i aktit të ekspertimit psiko-social, të interpretimit të gjuhës etj. Kjo ishte e para.

E dyta, në rast se lexojmë pikën 5 të nenit 14 të ligjit që ndryshohet, thuhet se gjykata e kryen gjykimin në afatet e parashikuara nga ky ligj. Pra, kemi bërë një afat më të shkurtuar të gjykimit që është një problem shumë i madh, sepse nuk mund të jenë afate të gjykimit të zakonshëm dhe zbaton format e njoftimit të parashikuara në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale për palët dhe subjektet.

Shqetësimi që kishit ju që të mos ketë një procedurë të gjatë njoftimesh, edhe në diskutimin, edhe në sugjerimin që bëri kolegja Bushka, thuhet se është rregulluar shumë mirë dhe këtë e konfirmon edhe përfaqësuesi i Ministrisë së Drejtësisë në këtë kuadër.

Gjithashtu, në këtë pikë, ajo që thoni ju nuk ka gjetur rregullim, sepse nuk ka të bëjë pikërisht me këtë nen, por ne kemi një nen tjetër, nenin 12, që ndryshon nenin 15 të ligjit.

Ulsi Manja – Dakord.

Kush është dakord me nenin 11 që ndryshon nenin 14 të ligjit aktual, sipas variantit të riformuluar nga relatorja?

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 11, që ndryshon nenin 14 të ligjit.

Kalojmë te neni 12, që ndryshon nenin 15 të ligjit aktual.

Vasilika Hysi – Pikërisht në këtë nen kemi një ndryshim të fjalisë së dytë të pikës 2 të ligjit. Këtu diskutohet si të ulet ngarkesa e viktimave. Kemi rastet kur kërkuesi deklaron pamundësinë për sigurimin e dokumentacionit të parashikuar në këtë paragraf, si dhe në çdo rast tjetër kur gjykata çmon se plotësimi mund të bëhet shkak për vonesën, të cilat cenojnë thelbin e të drejtave të viktimës. Gjykata mund të urdhërojë dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm nga organet e administratës publike që e disponojnë atë.

Nga ana tjetër, zoti kryetar, do të doja të sillja në vëmendje se shumë institucione të administratës publike në kuadër të reformës së derregullimi, tashmë e kanë të qartë se cilat janë dokumentet, të cilat ato mund t'i sigurojnë direkt pa qenë nevoja t'ia kërkojnë viktimës.

Gjithashtu, kemi edhe një rregullim të përgjegjësive disiplinore në rastet e moslëshimit të dokumenteve të përcaktuara. Ky është shkak për fillimin e ecurisë disiplinore. I është lënë legjislacionit të posaçëm, sepse marrëdhëniet e punonjësve apo institucionet që lëshojnë dokumentet mund të rregullohen nga ligje të ndryshme, qoftë ligji i shërbimit civil, Kodi i Punës apo ligjet e tjera.

Kjo ishte.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Zoti Fino,

Po flitet për dhunën në familje.

Vasilika Hysi – Gjithashtu, zoti kryetar, do të doja të theksoja, që, pas diskutimit me ekspertët dhe përfaqësuesit e ministrisë, këshilltarja ligjore e komisionit, zonja Isida Koka, së bashku me stafin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kanë sjellë projektligjin në total, pra, pjesën integrale. Pra, projektligjin që do të diskutojmë dhe miratojmë sot e kemi integruar në pjesën tjetër të ligjit, që nuk ndryshon, për ta parë në logjikën e vet se si këto ndërhyrje afektojnë nene të tjerë.

Janë konstatuar dy probleme:

E para, lind nevoja të ndryshojë në nenin 11, pika 1, shprehja “përmban masat e mësipërme”, pasi tani nuk kemi vetëm nenin 10 që parashikon masat që mund të marrë gjykata me vendim gjyqësor në rast të një urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje, por ka edhe masa të tjera, që u parashikuan në nenin 13\1, që do të jepen nga organet përgjegjëse ose strukturat e specializuara.

E dyta, në nenin 12, pika 1, për shkak të ligjit të ri të organizimit të pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë, nuk quhen më gjykatat e rrethit gjyqësor, por gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm të shkallës së parë.

Kemi një shqetësim që e kemi diskutuar dhe që dua ta ndaj me ju: Në ligjin aktual këto lloj konfliktesh shqyrtohen nga seksionet e familjes, kurse në ligjin e ri për organizimin e pushtetit gjyqësor gjykatat kanë të drejtë të krijojnë degë të tyre, sepse do të kemi gjykata më të mëdha dhe seksione. Kur është fjala për seksionet e familjes dhe çdo seksion tjetër, numri i tyre kushtëzohet jo vetëm nga tematika, por edhe nga numri minimal i gjyqtarëve që duhet të ketë. Minimalisht do të jenë shtatë gjyqtarë.

Në parim unë mendoj që këto çështje duhen gjykuar nga seksione të posaçme, por mund të ndodhemi para problemit që në gjykata të caktuara seksionet të mos krijohen.

Ulsi Manja – Ato janë çështje që i ka zgjidhur ligji për organizimin ...

Vasilika Hysi – E kemi lënë për ta ... gjykata e juridiksionit të përgjithshëm e shkallës së parë. Më pas, nëpërmjet trajnimeve, kualifikimeve, por do ta theksojmë edhe në raport, do të inkurajojmë fort që aty të ketë edhe seksione të familjes.

Ulsi Manja – Dakord.

Vasilika Hysi – Madje, unë e kam diskutuar me zonjën Sheshi se si e kanë zgjidhur sot këtë problem dhe me tha që në shumë raste viktimat lëvizin nga një qytet në tjetrin. Kjo është kosto.

Etleva Sheshi – Prandaj, po të thuash “juridiksion i përgjithshëm”, është zgjidhje.

Ulsi Manja – E hedhim në votim nenin 12, që ndryshon nenin 15 të ligjit aktual.

Kush është pro nenit 12, me ndryshimet e bëra? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Miratohet neni 12.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm.

E hedhim në votim në tërësi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tom Doshi - E bëjmë siç funksionojnë gjykatat e apelit në rang qarku. Për shembull, siç është Gjykata e Apelit Shkodër, të jetë edhe kjo gjykatë.

Ulsi Manja – Mendoj se përdorimi i termit “gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm” e zgjidh shqetësimin.

Dy nenet e tjerë i kemi mbyllur apo...?

Vasilika Hysi – Jo, do t'i votojmë. Janë të reja që na kanë dalë nga ...

Alket Hyseni – Janë rregullime teknike.

Ulsi Manja - Janë çështje të teknikës legislative. Rinumërimi i neneve për shkak të neneve të reja që janë shtuar dhe përshtatja e referencave duhet të bëhet në mënyrë integrale në tekstin që do të votohet tani në Kuvend.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, ne kemi futur masat e menjëhershme të mbrojtjes që do të marrë Policia e Shtetit, por, nga leximi në total i ligjit me të gjitha shtesat që do të bëhen, nuk shikoj që kur punonjësi i policisë merr një referim nga viktimat, pra masa paraprake, që të bëjë edhe referimin në prokurori. Kjo është vepër penale direkt, i themi viktimës që të shkojë dhe të bëjë denoncimin në prokurori.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është një shqetësim që ju e prekët, në fakt.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe unë këtë po them: mund ta vëmë tek masat? E dyta, a nuk ka të drejtë viktimat të marrë një kopje të denoncimit që bën, të raportimit që bën? Sepse, në Kodin e Procedurës Penale viktimat e kanë të drejtën, kur ka denoncime në çështje penale, ndërsa ky është një ligj jopenal. A ka të drejtë viktimat të thotë...

Ulsi Manja – Ta detyrosh punonjësin e Policisë së Shtetit të bëjë kallëzim, kjo është çështje e vullnetit të viktimës që paraqitet, sepse punonjësi i policisë mund të dojë të bëjë kallëzim, por nuk do viktimat të bëjë kallëzim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tom Doshi – Pra, ka pasur raste që nuk ia ka bërë as denoncimin Policia e Shtetit. A dëgjon, zonja Vasilikë?

Vasilika Hysi – Po të dëgjoj. Këtë çështje e kam edhe unë merak.

Tom Doshi – Disa raste i kemi parë edhe nëpërmjet medieve, siç ishte edhe kjo vrasja në Don Bosko. Ajo i qe drejtuar policisë dhe policia nuk e kishte marrë në konsideratë. Më pas u krye krimi, u vra. Në këtë rast policia ka përgjegjësi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Kolegia Bushka ka një sugjerim.

Ulsi Manja – Gjithmonë çështja e kallëzimit, se këtu jemi në rastin e kallëzimit nga shtetasit, nuk jemi para rasteve të kallëzimit nga nëpunësit publikë, që janë punonjësit e policisë. Në ato raste kur viktimat shpreh dhe jep vullnetin për të bërë kallëzim, të jetë detyrim i punonjësit të policisë për të marrë kallëzimin dhe për t'ia adresuar organit kompetent.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klotilda Bushka – Atëherë, në këtë kuptim unë propozoj që te neni përkatës, ku flitet për veprimet dhe masat që kryen organi i policisë, të shtohet: “Referon çështjen në organin e prokurorisë, nëse viktima është dakord me këtë veprim”.

Alket Hyseni – Nëse kërkohet nga viktima. Dakord është kur ia shpreh.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atë thashë unë: të përdorim diku termat: “inkurajon dhe asiston”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klotilda Bushka – Nëse viktima është dakord, kjo është tjetër gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ushtrimi i dhunës është krim, sipas Kodit Penal. Është detyrim ligjor, automatikisht, sapo të paraqitet për të kërkuar urdhër mbrojtjeje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Spartak Braho – Po mori dijëni për këtë vepër penale, ai është i detyruar të bëjë kallëzim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alket Hyseni – Nëse punëtori i policisë nuk zbaton ligjin, kjo është tjetër gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tom Doshi – Ndaj punëtorit të policisë duhet të merren masa, sepse në këtë rast...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Alket Hyseni – Mund ta përdorim një fjali të tillë: “Në rast kërkese inkurajon, asiston dhe referon çështjen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Klotilda Bushka – jam dakord me propozimin që bën Alketi. Duhet bërë një shkrimje mes asaj që thotë Alketi dhe asaj që them unë. Do të ishte shumë mirë. Pra, inkurajon, mund ta themi në këtë formë, duke ua lënë detyrë këshilltarëve.

Alket Hyseni - Termi i saktë është “orienton”.

“Orienton dhe asiston, si edhe referon me kërkesë të...”

Ulsi Manja - Te cili nen doni ta shtoni këtë?

Vasilika Hysi - Te neni 13/1. Përfaqësuesit e ministrisë janë dakord?

Ulsi Manja – Urdhrat për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi - Nëse e ka, atëherë ta lëmë. Kam një pyetje për juve, pasi më ka dalë gjatë leximit të ligjit në tërësi. A keni njoftime për atë shqetësim që ngre kolegu Doshi, por edhe unë që nuk shkojnë denoncimet nga policia, nuk bëhen referimet?

Merita Xhafaj - Ka raste të kësaj natyre, është kjo arsyeja pse ne e diskutojmë këtu, ashtu sikurse ka edhe raste të tjera që viktimat janë nën presion dhe mund t'i kërkojnë policit se nuk duan të vazhdojë më tej, por policia duhet të kryejë detyrën e saj.

Ulsi Manja- E hedhim në votim në tërësi projektligjin. Kush është dakord në tërësi me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar?”. Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji.

Harruat ndonjë gjë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Merita Xhafaj – Jo, nuk kemi harruar. Të gjitha aktet nënligjore u adresohen ministrive respektive për t'i nxjerrë. Do t'ju lutesha shumë që të shikoni këtë qëndrim, sepse ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe dhunës në marrëdhëniet familjare duhet të jetë koordinuese me ministrinë e tjera.

Vasilika Hysi - Do ta themi në raport.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Keni shumë të drejtë, por këtë gjë do ta ngremë në raport.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.07.2018, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Miratimi i projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorit të Përgjithshëm gjatë vitit 2017”. *(Komision përgjegjës)*

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Alket Hyseni, Edmond Leka, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Elena Xhina, Arben Pëllumbi dhe Tom Doshi.

Mungojnë: Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi Tyli, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Silva Caka.

Ulsi Manja- Kalojmë te pika e tretë e rendit të ditës që është miratimi i rezolutës:

“Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorit të Përgjithshëm për vitin 2017”. Komisioni ynë është komision përgjegjës. Relator është zoti Shameti. Të dëgjojmë zotin Shameti, lidhur me rezolutën për Prokurorin e Përgjithshëm. A është i dakordësuar teksti i rezolutës?

Adnor Shameti - Teksti i rezolutës është i dakordësuar.

Të nderuar kolegë, ju kemi paraqitur tekstin e rezolutës në lidhje me veprimtarinë e organit të prokurorisë. Teksti është i dakordësuar dhe pasqyron të gjitha gjetjet dhe rekomandimet për veprimtarinë e këtij të fundit për vitin 2017, si edhe konsideratat, sugjerimet për vitin 2018. Ju ftoj ta miratojmë këtë draft të paraqitur para jush.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja - Keni vërejtje dhe sugjerime për tekstin e projektrezolutës?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Adnor Shameti – Zoti Fino ju është nisur me *e-mail* paraprakisht.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo e mirë. Punën, veprimtarinë më saktë.

Alket Hyseni – Zoti Fino, a futen në rezolutë këto shifra kaq të detajuara, që të jemi mirë me teknikën legjislative?

Ulsi Manja – Kush është dakord me projektrezolutën “Për vlerësimin e veprimtarisë së organit të Prokurorisë së Përgjithshme mbi gjendjen e kriminalitetit për vitin 2017”?

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet projektrezoluta “Për vlerësimin e veprimtarisë së organit të Prokurorisë së Përgjithshme mbi gjendjen e kriminalitetit për vitin 2017”, si dhe rekomandimet për vitin 2018, për t’i kaluar seancës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 19.07.2018, ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Miratimi i projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2017”. (*Komisioni përgjegjës*)

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Bledar Çuçi, Alket Hyseni, Edmond Leka, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Elena Xhina, Arben Pëllumbi dhe Tom Doshi.

Mungojnë: Enkelejd Alibeaj, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi Tyli, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço, Silva Caka.

Kalojnë në pikën e katërt dhe të fundit të rendit të ditës: “Miratimi i projektrezolutës “Për vlerësimin e veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për vitin 2017”.

Komisioni ynë është komision përgjegjës. Relator është kolegu Adnor Shameti.

Urdhëroni, zoti Shameti!

Adnor Shameti – Faleminderit, zoti kryetar!

Sikurse e dini, se ua kemi nisur këto të dhëna edhe me email, projektrezoluta i përmbledh të gjitha gjetjet që kishim në seancën dëgjimore me kryeinspektorin e Inspektoratit të Deklarimit dhe të Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, prandaj ju ftoj të gjithëve ta miratojmë në variantin e paraqitur.

(Diskutime pa mikrofon)

Tom Doshi – Ne jemi mes kolegësh këtu, por në rastin tim për shembull, kur ILDKP-ja thotë për mua se kam 22 milionë euro pastrim, në një kohë që heton prokuroria dhe del nul, a mban përgjegjësi ky kryeinspektori për këtë, që akuzon tjetrin? A mban përgjegjësi? E njëjta gjë do të jetë nesër edhe për ju.

(Diskutime pa mikrofon)

... a mban përgjegjësi kryeinspektori, se mua më ka çuar në ndjekje penale... më ka ndotur figurën në opinion, kur thotë se kam 22 milionë euro pastrim... Dy vjet më ka hetuar prokuroria dhe janë 10 mijë faqe material, që s’ka ndodhur ndonjëherë qysh në ’91-shin me sa kujtoj unë, dhe në fund, megjithëse e kisha të gjithë prokurorinë kundër, del se nuk ka vepër... Prokuroria më ka çuar në gjyq, por jo për pastrim, por për mosdeklarim...

A mban përgjegjësi ky njeri?

(Diskutime pa mikrofon)

Adnor Shameti – Sa kohë që e ka çuar në prokurori, nuk ia vë ai emrin, emrin ia vë prokuroria ...

(Diskutime pa mikrofon)

Sa kohë prokuroria e ka çuar për gjyq, e ka kryer detyrën si duhet ai...

(Diskutime pa mikrofon)

Tom Doshi – Kryeinspektori që më ka dërguar mua për ndjekje penale, e ka firmosur vetë çdo vit që unë jam i pastër, por një ditë më mori në telefon dhe më thotë që duhet filluar edhe një herë nga e para. Pra nëse deklarimi i pasurisë është për 5 vjet, mua prokuroria, mbi bazën e IDKPKI-së më ka hetuar që në vitin 1991. Kanë shkuar të hetojnë te nëna ime dhe e kanë pyetur a ka ndërtim apo jo. Kjo është anormale.

Adnor Shameti - E mira e kësaj pune do të kishte qenë që këto gjetje t'i kishit paraqitur atë ditën e seancës dëgjimore që e kishim inspektorin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jam shumë dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë them ta votojmë, dhe pastaj e sqarojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A e kishim në seancë dëgjimore?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja- Ia ka garantuar ligji të drejtën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Shqetësimi yt e ka përgjigjen. Të takon e drejta të ngresh padi për dëmshpërblim. Në momentin që ti do të marrësh vendimin e formës së prerë, do të ngresh padi për dëmshpërblim dhe cenim të figurës. Ta garanton ligji këtë.

Tom Doshi - Pse ka kaq shumë kompetenca? Pra, ai që ju përmenda është njeriu më i korruptuar e dini të gjithë, jo se më ka bërë dëm mua. Pra, një njeri që ka certifikuar që jam në rregull, dhe më pas kthehes qe në vitin 2004.

Alket Hyseni – Të ka rënë shorti ty për kontroll.

Tom Doshi – Po më ka rënë shorti 5 herë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I dorëzoja dokumentet në fillim, në orën 16:00 më binte shorti.

Ulsi Manja – Kush është dakord me projektrezolutën për vlerësimin e inspektoratit të Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit për vitin 2017?

Pro? 1 Kundër. Abstenim nuk ka.

Miratohet kjo projektrezolutë për të kaluar për votim në Kuvendin e Shqipërisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Spartak Braho- Ne nuk i hyjmë rastit konkret, por institucioni duhet të jetë më i kujdesshëm.

Ulsi Manja - Është thënë në tekstin e projektrezolutës.

Me këtë pikë e mbyllim mbledhjen e komisionit për ditën e sotme.

Mbledhja e radhës së komisionit do të njoftohet nga sekretarisë së komisionit.

MBYLLET MBLEDHJA

